



LOYOLA – GYMNASIUM PRIZREN

Rendi i konviktit

Preambul

ALG-ja ofron shkolla si vende ku nxënësit dhe të rinjtë mësojnë dhe kuptojnë historinë dhe rrënjët e njerëzimit, fitojnë diturinë dhe shprehinë e krijimit të ideve, mësojnë të shijojnë arritjet, të ballafaqohen me humbjet dhe zhvillojnë mjetet e domosdoshme për ndërtimin e një të ardhmeje të përbashkët. Në këtë mënyrë, shkolla jonë përpiqet të inkurajojë nxënësit e saj me kompetencë, vetëdije dhe përkushtim të dhembshur.

Në të njëjtën kohë, ne përpiqemi të ofrojmë edukim për demokraci që është elementi kyç për zhvillimin demokratik të një shteti.

Për më tepër, ne e shohim veten si një element në sistemin e edukimit të Kosovës prandaj, në bazë të marrëveshjes mbi themelimin e shkollës, ne i respektojmë ligjet dhe udhëzimet e Kosovës.

Për t'i arritur këto qëllime "Loyola-Gymnasium" duhet të jetë një vend i sigurt ku secili është i vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrat e tij.

Një përparësi unike e "Loyola-Gymnasium" është mundësia e shkollimit me konvikt. Ky Rend i konviktit siguron udhëzime në mënyrë që të realizohet mësimi i qëllimshëm dhe nevojat e të gjithëve të përmbushen.

KONVIKTI NË "LOYOLA-GYMNASIUM"

"Loyola-Gymnasium" ka dy konvikte të ndara: një për vajza dhe një për djem, me kapacitet deri në 150 nxënës.

Konviktet janë të rregulluara dhe të mobiluara me inventarët e nevojshëm për banim. Të gjitha dhomat dhe hapësirat janë të dizajnuara për t'i përmbushur të gjitha nevojat e nxënësve për banim dhe studim.

Veçori dalluese e punës në konvikt është edhe siguria e nxënësve. Nxënësit konviktorë janë të mbikëqyrur nga ana e edukatorëve gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tyre në konvikt. Ata gjithmonë do të kenë ndihmën dhe përkrahjen e edukatorëve.

Të jetuarit në bashkësi ka një përparësi shumë të madhe, sepse aty jepen mundësi për të mësuar ndërtimin e raporteve të shëndosha me të tjerët dhe menaxhimin e kohës si në kushte të mira, ashtu edhe në të vështira. Bashkësia është vendi i shkëlqyer për zhvillimin e personalitetit të shëndoshë dhe të përgatitur për jetë.

PËRMBAJTJE

- **I. QËLLIMI / IDEJA E KONVIKTIT**
- **II. DETYRIMET E KONVIKTIT**
- **III. DETYRIMET E PRINDËRVE / MBIKËQYRËSVE**
- **IV. DETYRIMET E NXËNËSVE**
- **V. ORARI**
- **VI. KRITERET PËR PRANIMIN NË KONVIKT**
- **VII. KRITERET PËR LARGIMIN NGA KONVIKTI**
- **VIII. MASAT PEDAGOGJIKE**
- **IX. URDHËRESAT PËRFUNDIMTARE**

I. QËLLIMI DHE IDEJA E KONVIKTIT

1. T'u ofrojë kushte të barabarta të gjithë nxënësve pa dallime për zhvillim, shoqërim, socializim dhe arsimim të denjë për një shoqëri të zhvilluar;
2. T'u mundësojë të gjithë nxënësve një hapësirë për të shprehur talentin e tyre, përmes aktiviteteve të ndryshme;
3. Të krijojë një shoqëri vetëbesuese;
4. T'i aftësojë nxënësit në marrjen e përgjegjësisë;
5. T'i pavarësojë nxënësit në udhëheqjen e kompetencave të tyre sociale;
6. Të jetë një mjedis inkurajues dhe motivues për suksesin e nxënësve në mësim.

II. DETYRIMET E KONVIKTIT

Konvikti detyrohet që nxënësve t'u sigurojë:

1. Kushte optimale për mësim dhe edukim, nën mbikëqyrjen e edukatorit, si dhe kujdes për përparim të suksesshëm në përvetësimin e kërkesave mësimore;
2. Mjedis të përshtatshme për banim dhe mësim;
3. Ushqim të përshtatshëm (mëngjes, drekë, darkë);
4. Një konvikt që të jetë dëshmi e nderimit për të tjerët;
5. Bashkëpunim të sinqertë dhe pa kushte me autoritetin prindëror.

III. DETYRIMET E PRINDËRVE—MBIKËQYRËSVE

Prindërit—mbikëqyrësit, sipas përgjegjësisë morale, materiale dhe educative, detyrohen:

1. Së bashku me edukatorin, vazhdimisht të përcjellin suksesin dhe sjelljen e nxënëses-it gjatë shkollimit, jetës dhe punës në konvikt;
2. Të ofrojnë sinqeritet dhe pajtim me parimet e konviktit;
3. Ta njoftojnë edukatorin për çdo vizitë apo dalje jashtë konviktit, atëherë kur nxënësit qëndrojnë në konvikt.

IV. DETYRIMET E NXËNËSVE

Nga të gjithë nxënësit kërkohet:

1. Një qëndrim me respekt për të tjerët;
2. Kryerja me përgjegjësi e detyrës kryesore—mësimi;
3. Njoftimi i edukatorit për çfarëdo shqetësimi;
4. Kryerja me ndërgjegje dhe përgjegjësi e kujdestarisë së paraparë sipas planprogramit të caktuar dhe detyrave të tjera në konvikt;
5. Ta mbrojnë imazhin e vet, të konviktit, të rrethit dhe bashkësisë ku jetojnë;
6. T'i ruajnë gjërat e veta të vlefshme, përfshirë të hollat;
7. Të mos përdorin shprehje të pahijshme, lojëra të papërshtatshme;
8. Të mos krijojnë çrregullime dhe, në asnjë mënyrë, të mos përdorin duhan apo lëndë të tjera narkotike;
9. Të mbajnë qëndrim të mirë dhe të mos bëhen pengesë e zhvillimit normal të orës së studimit;
10. Të jenë pjesë e aktiviteteve në konvikt, të organizuara nga ana e konviktit, përveç rasteve të veçanta, me leje të edukatorit.

V. ORARI

Rendi i ditës duhet të mbahet sipas orarit dhe kushteve të nxënësve:

06:30 Zgjimi

07:10—07:45 Mëngjesi

13:15—14:00 Dreka

14:00—15:40 Koha e lirë

16:00—18:30 Mësimi pasdite (marendi 17:00- 17:20)

18:30—19:15 Darka

21:00 Përfundimi i të gjitha aktiviteteve të lira pas darkës

21:30—22:00 Koha e gjumit

VI. KRITERET PËR PRANIM NË KONVIKT

1. Regjistrimi u kërkon nxënësve dhe familjeve të pranojnë me përkushtim qëllimin dhe normat e Rregullores së shkollës, sidomos të atyre që lidhen me regjistrimin dhe qëndrimin vullnetar në konvikt;
2. Kalimi me sukses i provimit pranues në shkollë;
3. Të jenë të shëndetshëm dhe të aftë nga ana psikologjike, të gatshëm për bashkëpunim dhe jetë të përbashkët.

VII. KRITERET PËR LARGIM NGA KONVIKTI

Largimi nga konvikti, gjegjësisht prishja e marrëveshjes, mund të vijë në këto raste:

1. Me kërkesën e prindërve apo mbikqyrësve të nxënësve;
2. Nëse nxënësi me vetëdëshirë e lëshon konviktin;
3. Nëse nxënësi përjashtohet apo e lëshon me dëshirë shkollën;
4. Nëse nxënësi vjedh gjërat e konviktit apo shokut/shoqes së tij/saj;
5. Nëse nxënësi merr vërejtje për mosrespektim të urdhëresave të konviktit;
6. Nëse nxënësi përdor dhunë fizike, psikike, shantazh, drogë, marrëdhënie të papërshtatshme intime mes nxënësve;
7. Largimet mund të bëhen edhe në raste të tjera, në përputhshmëri me rregulloret e konviktit dhe në këshillim me edukatorët.

VIII. MASAT PEDAGOGJIKE

Nxënësit dhe grupet marrin masa shpërblyese për sukses në mësim dhe sjellje të mira.

Masa shpërblyese janë lëvdatat dhe shpërblimet. Këto u ndahen nxënësve, grupeve për sukses në mësim dhe sjellje të mira, si të dalluar në aktivitete të ndryshme.

Masa të tjera pedagogjike janë:

- Qortime nga ana e edukatorit;
- Vërejtje nga ana e Këshillit edukues;
- Suspendim nga ana e Këshillit edukues;
- Largimi nga konvikti atëherë kur nxënësi vepron kundër urdhëresave të ligjit, rregullave të konviktit si dhe urdhëresave të kësaj rregulloreje. Largimi nga konvikti nënkupton edhe largim nga shkolla dhe anasjelltas.

IX. URDHËRESA PËRFUNDIMTARE

Konvikti ruan të drejtën që të ndryshojë dispozitat e parapara me këtë rregullore.